

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË PODUJEVË : - Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil : me gjyqtarin Bujar Muzaqi, dhe procesmbajtësen Mirvete Ahmeti, në çështjen juridiko civile të Paditësve I.D. dhe H.D. nga Fshati Sh., Komuna e P. të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Xh. K., avokatë nga P., kundër të Paditures Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P., në çështjen kontestimore kompensim dëmi, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësve, dhe në prani të përfaqësuesit të autorizuar të të paditurit me datë 20.06.2013 morri këtë :

A K T G J Y K I M

- I. **PJESËRISHT APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve I. dhe H.D. nga Fshati Sh., Komuna e P., **SI E BAZUAR.**
- II. **DETYROHET** e Paditura Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P., t’ia paguan Paditësve për aksidentin e dt.09.07.2010 si pasojë e lëndimeve të pësuar dhe atë Paditëses H.D. në emër të kompensimit të dëmit jo material shumën prej 3.500,00 Euro, dhe Paditëses I.D. në emër të kompensimit të dëmit jo material shumën prej 2.500,00 Euro, e të gjitha këto me kamatë vjetore siç e paguajnë Bankat afariste në Republikën e Kosovës kursimtarëve të vet në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data e parashtrimit të padisë dt.09.07.2010 e të gjitha në afatin prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi dhe atë :

- **Paditëses H.D.:**

Në emër të dëmit jomaterial :

- Në emër të dhëmbjeve fizike shumën prej 2.000,00 Euro;
- Për frikë të përjetuar shumën prej 1.500,00 Euro;

- **Paditëses I. D.:**

Në emër të dëmit jomaterial :

- Në emër të dhëmbjeve fizike shumën prej 1.000,00 Euro;
- Për frikë të përjetuar shumën prej 1.500,00 Euro;

- I. Përtej shumës së gjykuar shuma në lartësi prej 8.700,00 Euro për paditësen I.D., dhe përtej shumës së gjykuar shuma në lartësi prej 8.000,00 Euro për paditësen H.D. dhe kërkesat për ushqim të përforcuar, për ndihmen e personit të tretë, dhe shpenzimet e mjekimit klimatik terapeutik për paditëset **REFUZHON SI TË PABAZUARA.**
- III. **DETYROHET** e Paditura Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P. që paditësve t’ia kompensoi në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumën prej 717,00 Euro, të gjitha në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditëset në padi ndër të tjera kanë deklaruar se me datën 09.07.2010, në magjistralen Pejë – Prishtinë gjegj. Në Fshatin Vragoli nga aksident trafiku Paditëset I.D. dhe H.D.kanë pësuar lëndime të rënda trupore, po ashtu kanë deklaruar se automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar te e Paditura.

Meqë aksidenti ka ndodhur në magjistralen Pejë - Prishtinë gjegj. në Fshatin Vragoli dhe në përgjegje në padi me datë 19.04.2013 e paditura nuk e ka kundërshtua kompetencën territoriale gjykata ka vepruar konform Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe e ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 22.05.2013.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 20.06.2013 përfaqësuesi i autorizuar i Paditësve av. Xh. K. deklaroi se mbetem në tërësi pranë Padisë dhe kërkespadiësë. Dhe mbështes thënjet dhe provat e paraqitura në padi dhe në kërkesën e saj. Bazuar në mendimin e ekspertëve kemi bërë precizimin e kërkespadiësë ku nga një kopje për të paditësen dhe për gjykatën dhe meqë baza juridike nuk është kontestuese i propozoi gjykatës që të miratoi padinë dhe kërkespadinë si dhe precizimin e saj.

E paditura në përgjegjen në padi të dt.19.04.2013 të dorëzuar pranë gjykates ndër të tjera ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkespadinë e paditësve.

Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 20.06.2013 përfaqësuesi i autorizuar i të Paditësve B. M. ndër të tjera ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjegjes në padi, deklarimeve nga seancat e kaluara.

Po ashtu ka deklaruar se e kundërshtoj precizimin e kërkespadiësë si të pabazuar në prova dhe fakte dhe atë duke pas parasysh mendimin dhe konstatimin e ekspertëve mjekësor A. T. –ortoped traumatolog dhe N. M. –psikiatër dhe e konfirmuar me ekspertizën e dr.V. B. – ortopedi traumatologje për çka është konstatua se H.D. dhe I. D. në aksidentin e trafikut të dates 22.05.2010 kanë pësuar lëndime të lehta

trupore dhe pa pasoja. Si dhe ka deklaruar se nga precizimi shoh se është përmendur dhe kërkuar rehabilitimi klimatik, ushqimi i përforcuar si dhe ndihma dhe përkujdesi i personit të tretë, për këto tri forma të kompensueshme të dëmit material dhe jomaterijal kërkoj nga gjykata që të administroj provat e nevojshme, mbi bazën e së cilës është bërë kërkesa dhe atë fakturat për rehabilitimin e mundshëm sipas mendimit të mjekëve, prova materijale për përdorim të ushqimit të përforcuar si dhe prova të tjera materiale lidhur me ndihmën dhe përkujdesjen e personit të tretë, dhe i ka propozuar gjykatës që të refuzohen si të pabazuara. Po ashtu në këtë seancë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurave ia ka ofruar një ofertë Paditësve për kompensimin e dëmit dhe atë shumë prej 350 euro për I. D. dhe dhe 650 euro për H. D. në total për të dy paditëset 1000 Euro.

Në seancen e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 20.06.2013 u administruan provat më të rëndësishme për vërtetimin e plotë dhe të drejt të gjendjes faktike siç janë : raporti i Shërbimit policor me nr.të rastit 2010-AR-1167 dt.22.05.2010, procesverballi i mbajtur pranë kësaj gjykate me dt.11.06.2013 në të cilin shqyrtim e kanë dhënë mendimin Dr.V. B., ortopede, Mendimi mjekësor dt.24.09.2010 dhënë nga Dr. N. M., psikiatre, Lexohet njoftimi për ofertë dt.16.10.2010, precizimi i kërkespadiisë dorëzuar nga avokati i paditësve Xh. K..

Pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës provë veç e veç dhe të gjithave bashkarisht e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, kjo Gjykatë lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko – civile vërtetoi se :

- Në bazë të Raportit të Shërbimit Policor të Kosovës me nr. të rastit 2010-AR-1167 dt.22.05.2010 u vërtetua se me dt.09.07.2010 ka ndodhur aksidenti trafiku në të cilin aksident Paditëset kanë pësuar lëndime trupore;

- Në bazë të njoftimit të dt.16.10.2010, dhe ofertes në seancen e dt.20.06.2013 ku e paditura ia ka ofruar një shumë Paditësve për kompensimin e demit, nuk është kontestuese baza juridike.

Në rastin konkret Gjykata mendimet e ekspertve ia dha besimin e plotë dhe i miratoj ne tërësi ekspertizat e kryera të cilat kanë elemente të mjaftueshme dhe të dhena mbi bazen e njohurive profesionale për vërtetimin e kesaj çështje kontestimore dhe atë ;

- Medimit të dhënë nga ekspertja mjeksore dr. V. B., ortopede e cila ndër të tjera ka konstatua se Paditësja I.D. në aksidentin e përjetuar ka pësuar : *Ndrydhje të kokës të regjionit okcipitla ose zverkor, ndrydhje të qafës, përdredhje të qafës.*

Ndërsa për Paditësen H.D. ekspertja mjeksore dr. V. B., ortopede ndër të tjera ka konstatua se në aksidentin e përjetuar ka pësuar : *Ndrydhje të kokës, , ndrydhje të qafës, përdredhje të qafës dhe ndrydhje të gjoksit.*

- Mendimit të dhënë nga ekspertja mjeksore dr. N. M., psikiatre, e cila ndër të tjera ka konstatua se Paditësja I. D. në aksidentin e dt.09.07.2010 ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë të manifestimit që ka zgjatur për tri ditë manifestuar me pagjumsi, frikë dhe pasiguri dhe që ka kaluar në frikë sekondare “

Ndërsa për *Paditësen H.D.* dr. N. M., psikiatre, ndër të tjera ka konstatua se në aksidentin e dt.09.07.2010 ka përjetuar ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë të manifestimit që ka zgjatur për tri ditë manifestuar me pagjumsi, frikë dhe pasiguri dhe që ka kaluar në frikë sekondare.

-Në lidhje me bazen juridike, përfaqësuesi i autorizuar i Paditësve në seancen e dt.20.06.2013, ia ka ofruar ofertën Paditësve për kompensimin e dëmit.

Andaj në bazë të ofertes të dhënë nga përfaqësuesi i autorizuar i të paditësve nuk është kontestuese baza juridike si e tillë, por dhe e njëjta vërtetohet në provat që janë në shkresat e lëndës.

Kontestuese mbetet vetëm lartësia e dëmit e precizuar nga i autorizuari i paditësit me dt.20.06.2013.

Lidhur me lartësit dhe shumat aprovuara për shpërblimin e dëmit material dhe jo material për Paditëset Ilmie dhe H.D. të përmendura sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi janë aprovuar bazuar në nenin 200 dhe dispozitave tjera të Ligjit mbi Mardhëniet Detyrimore, si dhe bazuar në nenin 323 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, po ashtu me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit kjo gjykatë pati në konsiderim të gjitha rrethanat që ndikojnë në përcaktimin e tij, intensitetin e dhimbjeve, kohëzgjatjen e tyre, intensitetin e frikes, dhe shumat e caktuara do të ofrojnë satisfakcion të duhur për dhimbjet e përjetuara dhe do të ndikojnë në vënjen e barazpeshës psikike dhe emocionale duke i refuzuar për tej pjesës së gjykuar shumat që në parashtresë i ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i Paditësve duke u bazuar në atë që shumat e aprovuara të mos i shkojnë përshtati synimeve të njërës palë për fitim pa bazë dhe kundër interesit të përgjithshëm shoqëror.

Kërkesat për ushqim të përforcuar, për ndihmen e personit të tretë, dhe shpenzimet e mjekimit klimatik terapeutik për paditëset u refuzuan si të pabazuara në mungesë të provave.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore Gjykata u bazua në nenin 452.2 par.2 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe Tarifes së Odes së Avokatëve dhe shpenzimet për përfaqësime në 3 seanca gjyqësore në shumë prej 363 Euro, për shpenzime të ekspertizave shumë prej 200 Euro, për përpilimin e padisë shumë prej 104 Euro, si dhe taksa për padi dhe taksa për aktgjykim në shumë prej 50.00 Euro.

Prandaj, nisur nga të lartcekurat dhe duke ju referuar nenit/eve 185, 200, 201 dhe dispozitave tjera të Ligjit mbi mardhëniet e detyrimeve dhe konform nenit/eve 4, 5, 7, 8 10, 321, 323 147.1, 452 dhe dispozitave tjera të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, dhe konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr.2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË PODUJEVË

C.nr.366/10 datë 20.06.2013

**Gjyqtari,
Bujar Muzaqi**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.